



Pranuar / Dostezuar Punimhem/Prizato Received/Delivredy	31-01-2023	3	viti God Year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prof Br Prof Prof No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKGJK	1163/2023		113



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.778/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2714/21, të datës 20.12.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.778/2021 të datës 30.08.2021, të parashtruar nga ankuesi

me adresë banimi fshati Fushticë e Poshtme, në Komunën e Drenasit , kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.778/2021 të datës 30.08.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, ka themeluar marrëdhënie pune me Këshillin Gjyqësor të Kosovës sipas Akt emërimit me numër të referencës 03 Referencë: 112.865 te datës 28.12.2012, ne pozitën "Vozitës" në Gjykatën Supreme të Kosovës-Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme,i pakënaqur me Vendimin numër Ka.nr.34/2021 të datës 27.07.2021 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së,me datën 30.08.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4439/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të vlerësimit te gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marr parasysh faktin se objekt i kësaj çështje ankimore është kompensimi material përkatësishtë pagesa e tri pagave përcjellëse dhe një pagë jubilarë me rastin e daljes në pension nga ankuesi i cili ka pasur statusin e *Nëpunësit administrativo-teknik- dhe mbështetës*, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafi 3 përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 6. *Nëpunës administrativo-teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*, konstatoi se pozita "Vozitës" të cilën e ka mbajtur ankuesi, hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.778/2021 të datës 30.08.2021 të parashtruar nga ankuesi.

Andaj, duke marr parasysh faktin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i SKGJK-së ka nxjerrë Vendimin numër Ka.nr.34/2021 të datës 27.07.2021 përmes së cilit vendim i ishte refuzuar ankesa si e pabazuar sa i përket kompensimit me rastin e pensionimit, Kolegji i Këshillit duke pasur parasysh rrethanat e konstatuara si më lartë konstaton se ankuesi me qenë se nuk e ka statusin e nëpunësit civil, si rrjedhojë as të kandidatit për pranim në Shërbimin Civil dhe për pasojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.778/2021 të datës 30.08.2021 të parashtruar nga ankuesi, ngase bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, Këshilli shqyrton dhe merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Sipas nenit 79 paragrafit 2 dhe nenit 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës. Kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafit 4 dhe nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesin se ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Nga ajo që u tha më lartë e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.778/2021, datë 31/01/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

